



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Ministrave**

**VENDIM**

Nr. 562, datë 28.5.2009

**PËR**

**HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT, "MASTER I NIVELIT TË DYTË", PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE, "JUSTINIANI I"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private, "Justiniani I", me seli në Tiranë, për hapjen e programit të studimit "Master i nivelit të dytë", në shkencat juridiko-penale.
  2. Programi i studimit "Master i nivelit të dytë" do të jete program studimi i ciklit të tretë, në plotësimin e të paktën 60 krediteve. Në perfundim të programit të studimit do të lëshohet diplomë "Master i nivelit të dytë", MND në shkencat juridiko-penale.
  3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private, "Justiniani I", që, për programin e studimit, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.
  4. Shkolla e lartë universitare private, "Justiniani I", do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.
- Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhezimin e tij për këtë qëllim.
5. Ndryshimet në vendodhje, forma e studimi, plane dhe programe si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
  6. Shkolla e lartë universitare private, "Justiniani I", duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
  7. Shkolla e lartë universitare private, "Justiniani I", pas marrjes së lejes përkatëse për programet e ciklit të tretë, nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, strukturohet si universitet.
  8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**SALI BERISHA**

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**FATOS BEJA**

Gjergj LEZHJA

Sekretari Përgjithshëm

